



# Ndërprerja e dhunës nëpër shkolla

Doracak për arsimtarë

Disejmi: Koma lab.

Botoi: Vinsnet grafika

Tirazhi: 5.600 ekzemplarë

## Parathënie

„Ndërprerja e dhunës nëpër shkolla: doracak për arsimtarë” është mund i UNESCO si përkrahje e Arsimit për të gjith si dhe për dekadën Ndërkombëtare të Kombeve të bashkuara për kulturë, paqe dhe jodhunë ndaj fëmijëve në botë (2001-2010).Ky doracak doli si rezultat i raportit Botërorë për dhunën ndaj fëmijëve nga viti 2006 i cili paraqet mundin e parë ndërkombëtar gjithpërfshirës për hulumtim të shkallës së dhunës ndaj fëmijëve, si dhe ndikimin e tij. Është botuar në kohë të duhur ,sepse këtë vit shënohet edhe 20 vjetori i Konventës për të drejtat e fëmijëve.

Derisa bota dëshiron ti arrijë qëllimet e Arsimit duhet për të gjith të ketë vëmendjen për dhunën në kontekst të të mësuarit.Ky doracak paraqet një hap të rëndësishëm për çrrënjosjen e dhunës në shkollë, dhe është si rezultat i mundit të madh i bërë nga ana e shumë ekspertëve ,educatorëve,pale të tjerë të interesuar ,institucione relevante për arritjen e këtij qëllimi.Janë mbajtur shumë mbledhje, seminare dhe konferenca për përkrahjen dhe zhvillimin e këtij doracaku.Ndër më të rëndësishmit është Mbledhja e Ekspertëve, „Ndalimi i dhunës nëpër shkolla:Cka është frytdhëse?”në të cilin nikoqir ishte selia e UNESCO-s në vitin 2007 dhe konferenca e 4 botërore për dhunën nëpër shkolla dhe politikën e hapur të sponsoruar nga ana e UNESCO-s, në organizim te opservatoriumit Ndërkombëtarë për dhunën në rrethin shkollor në vitin 2008 ne Lisbonë. Komiteti shkencëtar i opservatoriumit ndihmoi në përgatitjen e doracakut duke siguruar te dhëna dhe vlersime të çmueshme.

Arsimtarët dhe nxënësit mund ta përdorin doracakun për ndalimin e dhunës dhe përbaljen me të. Dhuna në shkollë paraqet një pyetje të ndërlikuar, prandaj është me rëndësi të përfshihen faktorë të ndryshëm. Faktorët e tillë kyçin edhe nevojën për pjesmarrje të nxënsit;..... me pjesmarjen e prinderve;educatorëve dhe shoqërisë; lidhshmërin e politikës;legjislacionit dhe praktikën;zhvillimin e indikatorve për dhunë; si dhe përgaditje të rrethit të angazhohet për konceptet siqë janë të drejtat univerzale të njerëzve si pjesë e hyrjes e bazuar tek të drejtat e njeriut.

Doracaku paraqet piknisjen për bashkësinë ndërkombëtare që të kalon në veprim. Çmimi i mosaktivitetit është shumë i lartë sepse gjurmët e dhunës fëmijët i ndejnë gjat gjith jetës ,ngadalësohet zhvillimi emotiv dhe kognitiv ,ka ndikim në shëndet, sjelljen dhe në fund në të gjith shoqërin. Asnjë lloj forme e dhunës nuk është e arsyeshme, dhe secila dhunë mund të ndërpritet.

Ky doracak është bërë për të na sjellë deri te ndryshimet rrënsore me atë që do tju ndihmojë shoqërive shkollore dhe bashkësisë ndërkombëtare më të gjerë që ti kundërvihen dhunës dhe të përdorin masa për parandalim të sajë.

## Hyrje

Përcjellja e dijes është vetem një segment nga puna e arsimtarëve. Ata japin kontribut kyç për zhvillimin emotiv dhe konjuktiv të fëmijëve dhe luajnë rolin kryesor në zhvillimin shoqëror dhe ndryshimeve. Dhe krahas kësaj ,për fat të keq ,disa fëmijë janë viktima të dhunës në shtëpitë e tyre, arsimtari mund të ofrojë mënyra alternative për të jetuar me atë me që do të modeloj sjellje konstruktive jo të dhunshme dhe do të

„Ndërprerja e dhunës në shkolla :doracak për fëmijë” hulumton format e ndryshme të dhunës çka ndodhin në shkollë dhe ofron propozime praktike për atë çka mund të bëj arsimtari që ta nderpret atë. Jan ofruar dhjetë vende per aksion, dhe secili përmban shembuj specifik të cilat arsimtari mund ti përshtat me përballimin dhe ndalimin e dhunës.

# Llojet e dhunës nëpër shkolla dhe pasojat e tyre

Egzistojnë shumë faktorë për dhunën nëpër shkolla .Këtu përfshihen të kuptuarit e ndryshëm për dhunën, faktori shoqëror-ekonomik, jeta e nxënësit në shtëpinë familjare dhe rrethin e jashtëm shkollor. Për shembull, mund të egzistojnë dallime të mëdha ndërmjet kulturave dhe shoqërive për definimin e asaj se çfarë paraqet një veprim i dhunshëm. Pa dallim nga kultura apo konteksti socio-ekonomik i shkollës, dhuna ndodh si në forma fizike, poashtu edhe në forma psikike.

*Raporti botëror i dhunës ndaj fëmijëve*<sup>1</sup> identifikon format themelore të dhunës në mënyrat si vijon:

- Dënim fizik dhe psikologjik
- Maltretim
- Dhunë seksuale dhe gjinore
- Dhunë e jashtme: efektet e bandave, situatat konfliktuozë, armët dhe rrahjet.

Në pjesën e ardhëshme janë të përshkruara katër format e lartëpërmendura të dhunës në shkollë me pasoja në arsim.

<sup>1</sup>Raporti botërorë për dhunën ndaj fëmijëve është lejuar nga sekretari general i Kombeve të Bashkuara për të siguruar kuptimin për natyrën, skallën, arsyet dhe pasojat e formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve(fizike, psikologjike dhe seksuale). Ai i përpunon pesë mjediset themelore në të cilat ndodh dhuna – familja, shkollat, institucionet për përkujdesje, si dhe objektet për paraburgim dhe burgjet, situatat punuese dhe në shoqëri dhe në rrugë.

## Dënim fizik dhe psikik

Komiteti për të drejtat e fëmijës (KDF) lëndimin trupor apo dënimin fizik e definojnë si dënim në të cilin përdoret fuqi fizike e cila, sado që të jetë e lehtë,ka për qëllim të ngallmojë dhimbje të caktuar ose pakëndshmëri.Në mjedisin e arsimit në dënimin e tillë përfshihet rrahja (,goditje;shuplakë;goditje nga mbrapa,) të xënësi me shuplakë ose me mjet.Poashtu ,ajo mund të jetë edhe shqelmim,dridhje ose shtyerje e nxënësit,grithje,pickim,kafshim,tërheqje për flokë,goditje nga veshët,e detyron nxënësin të rinë në pozitë të pakëndëshme,djegje,nxehje ose larja e gojës me sapun në mënyrë të dhunshme.

Dënimi tupor ,sipas Komitetit , është degradues.

Egzistojnë edhe shumë forma të tjera jofizike për denim të cilat janë të vrazhdë dhe përrulës. Në këto dënime bëjnë pjesë nënvleftësimi, poshtërimi, frikësimi, kanosja ose përqeshja e nxënësit. Poashtu ,përdorimi i dhunës nga ana e të riturit cka është më i madh dhe më i fuqishëm se nxënësi dukshëm jep porosi të fuqis, kontrol dhe frikësim ,duke e vërtetuar faktin se akti i agresivitetit fizik është ngushtë e lidhur me agresivitetin psikik.

## PASOJA (konsekuencë)

---

Dënimi fizik apo trupor len pasoja serioze në shëndetin mental dhe fizik të nxënësit. Ajo është e lidhur me zhvillimin e ngadalshëm të shkathësive sociale, depresionin, ankthin, sjelljen agresive dhe mungesën e empatisë ose kujdesin për të tjerët. Ashtu , dënimi trupor është vetëm i dëmshëm për nxënësin ose fëmijën që përdor, por edhe për arsimtarët, perkdhelësit dhe nxënësit fëmijët e tjerë sepse paraqet vështirësi të cilat rëndë tejkalohen. Dënimi trupor , poashtu, paraqet pezmatim dhe armiqësi ,duke e bërë më të rëndë lidhjen në mes arsimtar-nxënës dhe nxënës-nxënës në paralelen. E bënë të rëndë punën e arsimtarëve, me efekte të vogla ekskluzivisht frustruese. Më tutje , lihet mbrapa mësimi me të cilin paraqitet mendimi kritik të nxënësit , bien vendime të shëndosha morale, ..... Dënimi i këtyllë nxënësve ju tregon se përdorimi i dhunës- qoftë ajo verbale, fizike apo emotive- është e pranueshme, veçanërisht kur përdoret ndaj më të rinjve ,person më të dobët. Kjo mënyrë e të dënuarit çon deri në numër më të madh incidentesh dhe malltretimesh dhe dhunë të përgjithshme në shkollë.

---

## Malltretimi

Llogaritet se nxënësi është i malltretuar kur një kohë të gjatë është i ekspozuar në sjellje agresive i cili me qëllim paraqet lëndim apo pakëndshmëri nëpërmjet kontaktit fizik, sulmim verbal, rrahje ose manipulim psikologjik. Tek malltretimi hyn fuqia e pabarabartë e cila kryç ngacmim, përqeshje, përdorim të pseudonimeve fyese, dhunë fizike ose ekskluzivitet social. Fëmijët mund të marrin pjesë në malltretim vetëm ose në grupe të moshatarve. Malltretimi mund të jetë direkt, shembull: kur një fëmijë nxjerrë me dhunë të holla ose mjete nga fëmijë tjetër, ose indirekt, shembull: kur një grup nxënësish përhapin gënjeshtër për një fëmijë tjetër. Sajber malltretimi paraqet shqetësim nëpër mjet e-mail adresave, celularit, porosive tekstuale, veb sajteve ofenduese.

Fëmijët janë më të ndijshëm nëse kanë ndonjë mangësi manifestojnë afinitete të ndryshme seksuale, rrjedhin nga etnitete të pakicave, grup kulturorë ose kanë status të caktuar socio –ekonomik.

Malltretimi ndonjëher rezulton me sulme fatale fizike.

## PASOJAT:

---

Si fëmijët që malltretojnë poashtu edhe për viktimën cikli i dhunës dhe frikësimit sjellë deri te pengesa më të mëdha te personi dhe sukses të dobët në shkollë. Më e besueshme është se nxënësit të cilët janë të malltretuar janë depresiv, të vetmuar ose në ankth dhe me shkallë më të ulët të vetëvlersimit nga moshatarët e tyre. Fëmijët të cilët marrin pjesë në malltretim të fëmijëve tjerë shpeshherë duken agresiv përshkak frustracioneve vetanake, nënçmimeve, hutisë si dhe rezultatit ndaj ekspozimit ndaj përqeshjes nga rrethi social.

---

## DHUNA SEKSUALE DHE GJINORE

Dhuna gjinore mund të jetë psikologjike, fizike ose formë seksuale e cila imponohet ose shfaqet në fuqi të pabarabartë në mes të gjinive. Dhuna gjinore zbatohet me qëllim që të shfaqen pabarazi gjinore, stereotipet dhe rolet e imponuara sociale. Edhe përkrah asaj se vajzat më shpesh janë të ekspozuara në dhunë gjinore dhe seksuale edhe meshkujt janë të ekspozuar në rrezik.

Dhuna gjinore në shkollë mund të jetë fizike, shembull: dënim trupor tek vajzat të cilat nuk sillen në mënyrë “femërore”. Mund të jetë seksuale si për shembull përdhunimi. Mund të jetë shqetësuese ose shfrytëzuese nga ana e nxënësve tjerë, arsimtarë ose personeli shkollor, ose mund të jete psikologjike, si për shembull fajsimi i viktimës së përdhunuar. Ndonjëher në formë të dënimit ose turpërimit të nxënësve për shkak të gjinisë ose përcaktimit seksual.

### PASOJAT:

---

Jan të kufizuara të dhënat të cilat janë për ekspozimin e nxënësve ndaj dhunës seksuale në shkollë, për shkak se viktimat nuk e lajmrojnë aktin e dhunshëm seksual nga frika se do të jenë të turpëruar, “me vulë”, nuk do të ju besojnë ose do të ju hakmerren.

Sulmi seksual dhe forma të tjera të dhunës gjinore janë faktor të rëndësishëm të shkalles së ulët të regjistruara dhe shkallës së lartë të çregjistruara të vajzave. Dhuna gjinore jo vetëm se i demoralizon vajzat të shkojnë në shkollë, por edhe prindërit mund t'i ndalin vajzat e tyre nga frika se edhe ata mund të jenë viktimë. Dhuna seksuale ndaj djemve në shkollë mund të paraqet turp sepse shpeshher ajo është tabu temë.

Dhuna seksuale dhe gjinore i ekspozon nxënësit në rrezik nga sëmundjet ngjitëse të cilat përcjellen nepërmjet marrdhënieve seksuale, nga shtatzania e padëshiruar, nga shkalla e ulët e vetëbesimit dhe ulja e suksesit në shkollë . Gjithashtu kjo ka pasoja edhe ndaj familjes dhe bashkësisë.

---

## Dhuna e jashtme; efektet e bandave, situata konfliktuozë, armë dhe rrahje.

Dhuna e cila ndodh jashtë rrethit shkollorë, siqë janë: dhuna e bandave, konfliktet policore, brutaliteti i policies, dhuna familjare shpeshherë ripërsëritet edhe në rrethin shkollorë.

Dhuna e bandave përfshinë rrahje, shpim me thikë dhe krisma e cila ka tendenca të jetë më e ashpër, madje edhe vdekjeprurëse, krahasuar me forma të tjera të dhunës në shkollë, veçanërisht kur është e lidhur me tregëti të palejuar me narkotik. Jostabiliteti politik dhe konfliktet përfshirë këtu edhe brutalitetin policorë, poashtu janë shembuj për dhunë të jashtme e cila ka ndikim të madh ndaj natyrës së dhunës në shkollë.

Dhuna e jashtme në shoqërinë e cila e rrethon shkollën mund ta përfshijë edhe shkollën, e cila mund të rezultojë me mbajtjen e armëve dhe zmadhim të akteve të dhunshme. Nxënësit mund të mbajnë armë sepse ndjehen të rrezikuar sepse pistoletat dhe armët janë të pranueshme si pjesë e jetës së përditshme në shoqëri. Rrahjet zakonisht paraqesin konflikt në të cilin nuk është e lehtë të bëhet dallimi ndërmjet sulmuesit dhe viktimës. Malltretimi mund të sjellë deri te rrahja, me ose pa armë.

## PASOJAT:

---

Kur fëmijët janë të kyçur në banda ose jetojnë në shoqëri në të cilat bandat dhe drogat janë pjesë e mënyrës së jetesës, ajo mund të sjellë deri te rrahjet, armë dhe dhunë të ndërlydhura me drogë në kuadër të shkollës.

Situatat konfliktuozë mund të zvoglojnë aftësinë e nxënësit për mësim dhe pjesëmarrje në shkollë. Konfliktet, poashtu mund të kenë ndikim edhe në infrastrukturën e shkollës, pranimin e arsimtarve të kualifikuar dhe menaxhimin me materialet shkollorë. Nga raportet e vendeve në konflikt është vërtetuar se situata konfliktuozë i ekspozon nxënësit në dhunë, duke e rritur rrezikun ato të jenë viktimë brenda dhe jashta shkollës.

---

# Dhjetë aktivitete për ndërprerjen e dhunës në shkollë:

Kjo pjesë ofron dhjetë qarqe për aksion me shembuj të përshtatshëm praktik, të dizajnuara për arsimtarët që të mund të merren dhe të ndalojnë dhunën në klasë dhe shkollë. Disa janë aktivitete bazë të cilat arsimtarët duhet menjëher ti zbatojnë në klasë si që është përdorimi i disciplines konstruktive dhe eliminimi i dhunës trupore. Për të tjerët është e nevojshme pjesmarrje në kuadër të shkollës dhe shoqërisë, si për shembull, zbatim të mekanizmave të sigurisë në shkollë.

Në çdo qark për aksion është dhënë një aktivitet në klasë të cilën arsimtari mund tua propozojë nxënësve. Këto aktivitete në klasë kanë për qëllim tju ndihmojnë nxënësve në formimin dhe mirëmbajtjen e komunikimit harmonik me bashkpuntorët e tyre dhe arsimtarët. Ato mund të prezentohen nga ana e arsimtarit si pjesë e diskutimit në klasë ose mund të përdoret si fillim i aktiviteteve të ardhshme kreative, si që është loja me role ose gara për të bërë postera. Me dhënien e drejtimeve specifike nxënësve të cilët i plotësojnë aktivitetet praktike të arsimtarit, mund të stimulohet dialogu ndërmjet arsimtarit dhe nxënësit.

Këto dhjetë qarqe për aksion për arsimtarët dhe nxënësit nuk paraqesin zgjidhje për dhunën në shkollë. Këto shërbejnë si ndihmë për zhvillimin e kulturës jo të dhunshme shkollë dhe duhet të jenë të përshtatshme për çdo mjedis shkollorë në drejtim të dialogut të përhershëm ndërmjet arsimtarëve dhe nxënësve, si dhe drejtorit të shkollës, këshilltarve, liderve të bashkësive dhe shoqatave të prindërve. Pozitive, pa dënime dhe pa dhunë shkolla ua siguron të drejtat të gjithëve – si arsimtarëve ashtu edhe nxënësve.

# 1. Përfaqsoni qasje me nxënësit, kuadrin shkollorë, prindërit dhe bashkësinë

- Bisedoni me drejtorin e shkollës, shërbimin përgjegjës, kolegët, nxënësit, prindërit dhe udhëheqsit e shoqërisë që të arrini mirkuptim të përbashkët për problemin e dhunës në shkollën tuaj. Arsimitarët nuk mundin ta ndalojnë dhunën në shkollë. E gjithë bashkësia shkollorë duhet të bashkohet që të arrijë marrveshje të qartë dhe të forta me porosi se dhuna, malltretimi seksual, malltretimi dhe jotoleranca janë të pa pranueshme në mjedisin shkollorë. Kur të gjithë do jenë të vetëdijshëm për mënyrat e ndryshme se si paraqitet dhuna, njerëzit të cilët janë të rrezikuar dhe ndikimi i tyre, do të jetë shumë lehtë të gjendet zgjidhje.
- Ndhmoni shkollën tuaj që të zhvillojë një plan për aksion në bashkpunim me të gjitha subjektet e lartpërmendura, si dhe me ekspertët e shëndetsisë , zbatuesit e ligjit, biznesit dhe grupet e tjera të rendësishëm në shoqëri. Planet për ndalimin e dhunës të zhvilluara me konsultime të gjëra dhe bashkpunim kanë më tepër shanse të kenë sukses se sa ata të cilat janë të përgatitura vetëm nga një grup profesionalistësh.
- Shikoni se në çfarë mënyre shkolla juaj mund të zvogëlë faktorët e rrezikut, për shembull sigurimin mjedisit me atë që do të mësoni nxënësit me shkathtësi për zgjedhjen e konflikteve pa përdorim të dhunës. Zvogëlimi i mundësive për dhunë dhe dhënien e mjeteve nxënësve për ndalimin e dhunës janë poashtu kyçe për një shkollë të sigurt.

**Aktivitete në klasë:** Luteni nxënësit të bisedojnë njëri me tjetrin ,me arsimtarin e tyre , me shërbimin profesional për dhunën në shkollë. Kush është i rrezikuar dhe si ? Tek cili në shkollë dhe në bashkësi mund të drejtoheni për ndihmë ? Bëni listë të personave dhe organizatave të cilat mund tju ndihmojnë në ndalimin e dhunës në shkollë dhe bisedoni se në cilën mënyrë mund të arrihet deri te ato.

## 2. Bëni nxënësit partnerin tuaj në parandalimin e dhunës.

- Në kurikulumin shkollorë kyçni arsimim për të drejtat e njeriut dhe paqen. Mësoni nxënësit për të drejtat e njerëzve si dhe për të drejtat e moshatarve të tyre, arsimtarëve, antarëve të familjes dhe antarët e bashkësisë. Mund ti mësoni për të drejtat e njerëzve dhe të drejtat e fëmijëve nëpërmjet përrallave, debateve luajtjen e roleve, lojra dhe ngjarje aktuale dhe në të gjitha ato nxënësit janë të angazhuar të bëjnë analiza dhe ta përcjellin dijeninë e tyre për të drejtat e njerëzve në realitet dhe në shkollën e tyre dhe bashkësi.
- Shfrytëzoni verzionet e nxënësve nga deklaratat univerzale për të drejtat e njeriut si dhe konventës për të drejtat e fëmijëve në forma të shkruara dhe formë elektronike. Në të dy dokumentet është e shkruar e drejta e çdo njeriu në arsim dhe e drejta të rritet dhe të mësojë në mjedis të sigurt. Bisedoni për këto dokumente me nxënësit e juaj dhe përpuni të gjeni mënyrë se si të drejtat e njerëzve çdo nxënësi ti respektohet, të jetë i mbrojtur dhe i respektuar në klasë.
- Detyroni nxënësit ti caktojnë rregullat dhe përgjegjësitë në klasë. Luteni klasën të shkruaj kodin e mirësjelljes sëbashku me ju. Cilat veprime janë të drejta, cilat veprime do të lëndojnë të tjerët ose do ta prishin qetësinë tek paralelja dhe cilat aktivitete janë me rëndësi që të mund të spjegoni, dhe nxënësit të mund të mësojnë në mjedis të qetë. Shkruarja së bashku i kodit të mirësjelljes i vendos në pozitë të qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjithëve dhe e rrit pjesëmarrjen e nxënësve.

**Aktivitete në klasë:** Lutni fëmijët të bisedojnë me juve dhe në mes veti për atë se çfarë është sjellje e dhunshme, e çfarë jo. Cilat të drejta specifike nuk respektohen në aktin e dhunës? Propozoni mënyra me të cilat do të rritet vetëdija për të drejtat e njerëzve në shkollë dhe promovoni respektimin e dallimeve, për shembull nëpërmjet debatave, mësim në natyrë, lojra, lojra me role dhe tregimi i përrallave.

### 3. Përdorni metoda dhe masa konstruktive dhe disiplinore

- Rregullat në klasë duhet të jenë pozitive, instruktive dhe të shkurtra.

Kur do të përgatiten rregullat, lista duhet të përmbajë më së shumti pesë ose gjashtë rregulla. Lista duhet të jetë e thjeshtë dhe koncize. Rregullat duhet të jenë të parashtruara pozitivisht, e jo negativisht, qartë ti drejtojnë nxënësit si të sjellen. Keni kujdes të mos jenë në kundërshtim me politikën e përgjithshme shkollore.

- Zabtoni përkrahje pozitive:

Përkrahni sjelljen konstruktive nëpër mjet kontaktit me sy, levizje me kokë ose me buzëqeshje. Mund ti shpërbleni nxënësit edhe me pike kredituese plotësuese ose pes minuta lojë në fund të ditës. Për nxënësit paraqet shpërblim i veçantë nëse përpara tyre përmendni sukses të arritur. Mund të nominoni grup i cili është sjellë më mire atë javë dhe emrin e tyre ta ekspozoni në një vend ku do të shihet më së miri në klasë.

Kur përdoren mirnjohje të tilla ato duhet të jenë direkte dhe të vogla por gjithsesi shpërblyese.

- Zbatoni masa disiplinore të cilat janë frytdhënëse e jo dënuese. Duhet të jeni të sigurt se kur zbatoni masa disiplinore ndaj ndonjë nxënësi ajo masë duhet të jetë e fokusuar në sjelljen jo të mire të nxënësit dhe ndikimin e kësaj sjelljeje e jo në vetë nxënësin. Varësisht nga natyra e sjelljes jo të mire disa nga masat disiplinore mund të jenë si vijon:
- Ndani kohë pas orës së mësimi ose në kohën e pushimit të bisedoni për sjelljen e pahijëshme – pse ka ndodhur dhe çka duhet të ndërmerret që të përmirsohet.
- Kërkoni nga nxënësi të kërkojë falje;
- Ndërroni vendet;
- Dergoni porosi tek prindërit ose vizitoni ato në shtëpi;
- Analizoni seriozitetin e situatës dhe varësisht nga situata vendosni nëse do ta çoni nxënësin tek drejtori i shkollës.

Aktivitete në klasë: Propozoni nxënësve të formojnë një klub kundër dhunës. Mund tju ndihmoni të organizojnë aktivitete për promovimin e një kampanje të qetë dhe shkollë e sigurt për të gjithë.

## 4. Bëhuni fuqi efektive dhe aktive për parandalimin e maltretimit.

- Punoni sëbashku me arsimtarët, përfaqsesit e nxënësve, kuadrin shkollorë dhe antarët e bashkësisë për zhvillimin e definicionit të përbashkët për maltretim që të mund të gjith të angazhohen për të njejtat qëllime. Tek maltretimi hyjnë:
  - Maltretim fizik: goditje , shkelmim, shtyerje, ngulfatje, dhe boksim.
  - Maltretim verbal: kanosje, përqeshje, ngacmim, urrejtje.
  - Çkyçje sociale.
- Vazhdimisht ekspozoni konsekuencat nga agresioni verbal dhe fizik. Konsekuencat efektive:
  - Jan të vogla që të mund të përdoren vazhdimisht;
  - E zmadhojnë rreptësinë gjat përsëritjes së sjelles aggressive.
  - Jan të parapara dhe direkte;
  - Bazohen në qëllime të njëjta nga të gjith nxënësit.

Thjesht konsekuencat kyçin humbjen e kohës së lire, si për shembull pauzë, drekë me bashkëpunorët ose aktivitetet jashtë shkollore

- Inkurajoni shërbimin profesional ose kuadrin të japin shërbime këshilldhënëse për dhunuesit paralelisht me implementimin e konsekuencave.

Përkrahni nxënësit të cilët janë caku i maltretimit. Inkurajoni të bisedojnë me arsimtarët dhe shërbimin profesional, poashtu punoni edhe me prindërit, nxënësit dhe kuadrin për ti mbrojtur të mos bëhen përsëri viktima të maltretimit.

- Përkrahni dhe mësoni vëzhguesit të ju tregojn të rriturve, përkrahni ato që janë të maltretuar dhe ndaloni maltretimin. Një mënyr që kjo të arrihet është nëpërmjet bashkëpunorve dhe programet për zgjedhjen e konflikteve të cilët i edukojnë nxënësit të përkrahen, ti lajmërojnë aktet e maltretimit dhe mësojnë strategjit për zgjedhjen e konflikteve.
- Jepni mirnjohje dhe faleminderim për aktivitetet e fëmijëve të cilët përkrahen në mes veti për ta ndaluar maltretimin. Njëlloj është e rëndësishme të sigurohet që ato që paraqesin maltretim të mbrohen nga hakmarrja.

**Aktivite në klasë:** Luteni nxënësit të bisedojnë me ju dhe në mes veti për atë çka është sjellje e dhunshme e çka jo. Cilat të drejta specifike nuk respektohen në aktin e dhunës ? Propozoni mënyra me të cilat do të ngritet vetëdija për të drejtat e njeriut në shkollë dhe promovoni respektimin e dallimeve, për shembull nëpërmjet debateve, mësim në natyrë. Lojra, lojra me role dhe tregimin e përrallave.

## 5. Ndërtoni qëndrueshmëri te nxënësit dhe ndihmohuni që në mënyrë konstruktive tju përgjigjen sfidave në jetë.

- Ndërtoni qëndrueshmëri te nxënësit dhe aftësi që me sukses të merren me sfidat e përditshme, stresin dhe fatkeqësitë me atë që do tju ndihmoni të ndërtojnë marrdhënie positive me të tjerët. Qëndrueshmëria më e lartë e zvoglon mundësinë që nxënësi të reagojë me dhunë ose të jetë victimë e sajë. Arsimtarët të cilët demonstrojnë sjelle sociale dhe konstruktive, ju japin drejtim dhe ju ofrojnë mbrojtje, e zmadhojnë qëndrueshmërinë e nxënësve me atë që tregojnë mënyra pozitive dhe alternative me të cilat mundë tju përgjigjet sfidave në jetë. Arsimtarët e tillë paraqesin model pozitiv me përkujdesje të plotë.
- Kyçeni shkollën tuaj në program për arsim dhe paqë për ndërtimin e shkathtësive, zgjedhjeve të konflikteve. Programet për arsim dhe paqë ua mundësojnë nxënësve të kuptojnë si vjen deri te dhuna, të zhvillojnë aftësi konstruktive, ti përgjigjen dhunës dhe ti mësojnë cilat janë alternativat për dhunën.
- Inkurajoni shkollën tuaj të krijojë program shkollorë këshilldhënës. Shërbimet profesionale mund ti përmbajnë nxënësit që të merren me ngarkesat në jetën e tyre dhe të intervenojnë në mënyrë preventive. Ato mund ti përkrahin arsimtarët, kuadrin shkollorë në parandalimin dhe si të menaxhojnë me dhunën në mënyrë që:
  - Të ndikojnë si ndërmjetsues në situata në të cilat mendohet se do të eskalojnë në dhunë;
  - Do të ndihmojnë që të arrihet një marrveshje e qetë përpara se një situatë të eskalojë në dhunë fizike.
  - Do të punojnë si me viktimat ashtu edhe me dhunuesit dhe do të ofrojnë ndihmë psiko-sociale.
  - Do të promovojnë programe proaktive të dizajnuara të zgjedhin pyetje si që është maltretimi, keqpërdorim të drogës dhe aktivitetet e bandave.
- Organizoni lojra për parandalimin e konflikteve me nxënësit tuaj.

Luteni nxënësit të dramatizojnë një situatë si për shembull, “çka do të ndodhë nëse ballafaqohesh me një dhunues? Çka do të bësh?” Duke krijuar situatë reale nxënësit mësojnë si të ballafaqohen me stresin, me situatë të ndërlikuara dhe të panjohura. Poashtu organizoni lojra në të cilat nxënësi do të luan rol të ri, në realitet rol në të cilin do të mund të gjinden nxënësit e tjerë, me qëllim që të inkurajohet ngushllimi ndërmjet tyre. Luteni nxënësit të flasin për atë se si janë ndjerë dhe cilat zgjidhje kanë qenë të suksesshme.

- Tregojuni nxënësve se veprimet dhunuese dhe fjalët, pa marrë parasyshë sa janë të pa vlefshme nuk do të tolerohen. Zbatimi i vazhdueshëm i masave disiplinore pas ndonjë gabimi të bërë në shkollë paraqet porosi të qartë deri te nxënësi se keqpërdorimi dhe mosrespektimi i të drejtave të të njëjtit është e patolerueshme.

**Aktivitet në klasë:** Organizoni aktivitet për luajtjen e roleve në të cilat nxënësit do të dramatizojnë konflikte të ashpra. Luteni fëmijët të bisedojnë për çdo konflikt dhe të gjejnë mënyrë për zgjidhjen e qetë të tyre.

## 6. Bëhuni shembull pozitiv me atë që zëshëm do ti kundërviheni dhunës seksuale dhe gjinore.

- Mbani llogari për paragjykimet gjinore. Ato nxisin diskriminim gjinor. Ndonjëher qëndrimi i arsimtarëve ndaj djemve është më i ndryshëm se sa ndaj vajzave. Për shembull, disa prej tyre mendojnë se meshkujt janë më të mirë në matematikë ose janë telegjent nga natyra, deri sa vajzat i llogarisin si të qeta dhe dashamirëse. Ndërpritni stereotipet dhe të priturat e ndryshme nga vajzat/grate dhe djemt/burrat. Ngriheni vetëdijen për paragjykimet gjinore në mësonjtore dhe nxitni kolegët tuaj të veprojnë në të njëjtën mënyrë. Djemt janë si zbatuesit ashtu edhe viktimat e dhunës seksuale në shkollë, ashtu që arsimtarët nuk duhet të fokusohen vetëm tek femrat viktimat.
- Mundohuni që interakcioni i juaj me djemt të jetë i ngajshëm me atë që keni me vajzat. Kualiteti i ulët i interakcionit të arsimtarit me vajzat mund ta zvogëlë vetëbesimin dhe vetëvlerësimin, ashtu që nga ana tjetër e rrit mundësinë që të bëhen viktimat. Një mënyrë që të nxiten vajzat që të marrin pjesë në paralelen është ajo që të ndahen nxënësit në grupe për diskutim në të cilat vajzat do të jenë shumicë në grup ose në grupe. Zakonisht vajzat më lirshëm shprehin kur janë në grup me vajza tjera.

- Sakrifikoni që shkolla juaj të ketë një program për stërvitjen e arsimtarëve, nxënësve dhe bashkësisë për tu kuptuar, identifikuar dhe zgjedhjen e rasteve të dhunës seksuale gjinore. Stërvitja duhet të rrisë vetdijësimin për paragjykimet gjinore të cilat paraqesin bazë për dhunën gjinore dhe të krijojë lidhjen ndërmjet dhunës ndaj vajzave në shkollë dhe numrin e zvogluar të vajzave që ndjekin mësimin dhe ato që ndërpresin shkollimin.
- Ndihejmi shkollën tuaj dhe bashkësisë që të shohin mundësin të mbrohen vajzat dhe grate në mjedisin shkollorë. Në situata konfliktuoze dhe postkonfliktuoze vajzat dhe grate janë veçanërisht të ndjeshme ndaj dhunës.
- Sakrifikoni për stërvitjen e kuadrit shkollorë për dhunën seksuale dhe gjinore dhe për pjesëmarrje më të madhe në strukturat udhëheqëse. Kuadri i stërvitur për të detektuar dhe përkrahur viktimat nga dhuna gjinore dhe seksuale ndihmon që të ndërpritet dhuna. Kyçja e grave në strukturat udhëheqëse ndihmon në përkrahjen e viktimave dhe i nxit viktimat që ta lajmërojnë dhunën seksuale.
- Ndalohehi heshtjen. Flisni zëshëm kundër dhunës dhe shfrytëzoni sa më mirë mekanizmat për lajmërim. Nxitni kolegët dhe nxënësit të tregojnë ekzekutuesit e dhunës në dhe jashta shkollës.

**Aktivitetet në klasë:** Thirrni nxënësit që të refuzojnë që fyhen dhe ngacmohen, veçanërisht në lidhje me dallimet gjinore. Çdo kush është i ndryshëm, por të gjithë jemi njëloj.

## 7. Sakrifikoni për mekanizma të sigurisë në shkollë.

- Përkrahni dhe insistoni që shkolla të ketë udhëheqje të fortë dhe efektive. E rëndësishme është që të punojë me arsimtarët dhe me qeveritarët e arsimit që të zhvillohet dhe implementohet politikë me të cilën eliminohet keqpërdorimi i forca, aktivitetet e dhunshme në fazën e tyre fillestare dhe të ndërtohet bashkësi të mirëbesimit nëpër shkolla.
- Ndihejmi shkollës tuaj të formojë kodin e sjelljes të bazuar në të drejtat që njohin të drejtën e secilit të mësojë në mjedis të sigurtë shkollorë, të lajmërojë aktet e dhunës pa hakmarrje dhe të merr pjesë në sjelljen e vendimeve.
- Sakrifikoni për mekanizma për lajmërimin çka do të nxit nxënësit që të flasin kundër dhunës. Shërbimet për lajmërim duhet të ofrojnë përkrahje, të ngushllohen dhe të jenë të besueshëm.

- Seriozisht kuptoni ankesat e nxënësve për dhunë dhe keni parasyshë mirqenien e tyre. Kjo do të thotë të jepni rendësi adekuate asajë që nxënësi e flet dhe të minimizoni situatën.

**Aktivite në klasë:** Propozoni që të organizohen sesione për bisedë me arsimtarët, nxënësit, drejtorin e shkollës dhe shërbimin profesional për të sjellë kodin e sjelljes për të gjithë në shkollë.

## 8. Siguroni vende të sigurta kun xënësit do të jenë të mirëseardhur.

- Zbatoni ushtrime për hartim me nxënësit që ti identifikoni vendet në shkollë të cilat janë të sigurt, të rrezikshme dhe kur nxënësit janë të ekspozuar në rrezik më të madh. Kuadri shkollorë duhet poashtu të jetë i njoftuar për këndet e errëta, vende jo mire të ndriçuara, shkallët dhe toaletet të cilat janë pa mbikqyrje dhe të cilat paraqesin rrezik për nxënësit nga keqpërdorimi seksual ose fizik.
- Kërkoni të ketë toaleta të ndara dhe të sigurta për vajzat dhe gratë. Një arsye e thjeshtë por e rëndësishme pse vajzat nuk vizitojnë shkollën është mungesa e tualeteve të pastra dhe të sigurta dhe hapsira të tjera të cilat mundësojnë privatësi.
- Punoni së bashku me kuadrin shkollorë që hapsirat për aktivitete sportive të jenë të sigurta me atë që do të sigurohet pjesmarje e të rriturve që do të mbikqyrin nxënësit. Nxënësve ju duhen vende të sigurta për lojë gjat orëve dhe pas.

**Aktivite në klasë:** Propozoni që të fillojë kampanjë për mjedis të sigurt shkollorë me atë që do të identifikoni vendet në rrethin shkollorë të cilat janë të pandriçuara dhe jo të sigurta.

## 9. Mësoni shkathtësi për ndalimin e dhunës dhe zgjidhjen e konflikteve dhe mësoni nxënësit.

- Stërvituni për zgjedhjen e konflikteve pa dhunë, për qasjen e udhëheqsit e klasës bazuar në të drejtat e njeriut për arsim dhe paqë. Luteni drejtorin ose fëmijët në zyrat lokale të Ministrisë së arsimit për mundësitë për stërvitje. Në aneksin II mund të gjeni

informata plotësuese për materijale që ofrojnë mënyra praktike për parandalimin dhe zgjedhjen e konflikteve në shkollë.

- Mundohuni të përdorni teknika për ndërmejsim në konflikte dhe mësoni nxënësit si ti përdorin për zgjidhjen e konflikteve personale.
- Mësoni fëmijët për shkathtësi për bisedime që do të ndihmojnë të:
  - (a) e definojnë konfliktin (" Për çfar debatojmë ? Pse dhe si u paraqit ky problem ?")
  - (b) shkëmbeni qëndrimet dhe propozimet (mendoj se duhet të jetë kështu sepse ...)
  - (c) shqyrtoni situatën nga të dyja perspektivat( për shembull , nëpërmjet luajtjen e roleve ose udhëheqjen e debateve)
  - (d) vendosni për opzione në të cilat të dy nxënësit do të dalin si 'fitues'(sot do të provojmë në mënyrën tënde, nesër në të imen , por do të shohim cila mënyrë është më e mire)
  - (e) arrini marrëveshje të arsyeshme.
  - (f) Mësoni nxënësit si të ndërmjetësojnë për arritjen e zgjedhjes konstruktive në konflikt të pjesmarrësve të tyre.
- Zgjidhni një problem i cili mund të paraqitet ose është paraqit ndërmjet nxënësve tuaj. Lutni dy nxënës të dramatizojnë problemin, ndërsa pjesmarrësi i tretë të ndihmojë që të vijnë deri në zgjedhje të problemit. Jepni instruksione nxënësit të tretë që të përdorë njohuri që posedon për pjesmarrësit e vet dhe për problemin dhe të propozojë çfar ai llogarit se do të jetë kompromis i mire.
- Pasi që të gjithë nxënësit do ti zotërojnë shkathtësitë për bisedime dhe ndërmjetësime çdo ditë ndani nga dy nxënës, sipas mundësive nje vajzë dhe një djalë, të jenë medijatorë/ paqëruajtës oficial. Këtë bëjeni derisa të gjith nxënësit nuk i zotërojnë teknikat e ndërmjetësimit. Roli i medijatorve oficial është të ndërmjetësojnë në proçese në të cilat nuk mund ti zgjidhin palët e involvuara.

**Aktivitet në klasë:** Ndihamoni nxënësit të ndërmjetësojnë në proçeset në mes pjesmarrësve të tyre. Çdo javë caktoni nga një paqëruajtës që të mund të gjith ti mësojnë dhe praktikojnë shkathtësitet për zgjidhjen e proçeseve dhe bisedave.

## 10. Shqyrtoni dhunën dhe diskriminimin kundër nxënësve me invaliditet dhe kundër atyre të cilët u takojnë vendasve, pakicave dhe bashkësive tjera të marginalizuara.

- Ndoshta do të duhet nxënësve të tjerë tua sqaroni shkaqet pse disa fëmijë sjellen ndryshe, kan vështirësi në të mësuarot ose janë të kufizuar në sport dhe aktivitete tjera fizike përshkak të mangësive të tyre mendore dhe fizike dhe vështirësi në mësim. Potencioni se të gjith antarët e bashkësisë së klasës dallohen në mpyrja të ndryshme, dhe kjo është ajo që i bën unikat. Dallimet duhet të respektohen. Çdo kush ka të drejtë të jetë i respektuar për atë çka është. Aktivitetet e ngajshme duhet të zbatohen në mbledhjet me prindërit.
- Mundohuni ti identifikoni paragjykimet ose kuptimet të cilat mundeni ju ose nxënësit e juaj ti futni në paralele. Lutni nxënësit që në mënyrë kritike të mendojn për kuptimet ose stereotipet me të cilat udhëhiqen me sjelljen e tyre ndaj atyre që dallohen nga ato. Modeloni sjelljen që do të doni ta kenë nxënësit tuaj.
- Menjëher flisni nëse ndëgjoni vërejtje diskriminuese. Flisni me nxënësit për atë sa mund të lëndojë fjala. Kujdes mos të vjen deri te dhuna fizike. Sa do që të jenë shanset të vogla për një gjë të tillë dhuna fizika i shoqëron ngacmimet raciste dhe diskriminuese.
- Kontrolloni kurikulumin dhe librat. A synojnë drejt zhvillimit të mirëkuptimit ndërmjet kulturave të ndryshme në shoqëri. A ndërtojnë mirëkuptim për dallimet dhe nxisin bashkjetesë?
- Largoni të bëni persona që flasin zëshëm për grupe të caktuara kulturore ose etnike. Vetëm ajo që do të arrihet me 'etiketimin' është të jenë të izoluar nga pjesa tjetër e nxënësve. Integrimi i tyre në klasë do ta rrisë vetëdijen për vlerat pozitive të dallimeve.

**Aktivitete në klasë:** luteni fëmijët të sjellen me pjesmarrsit e tyre ashtu siqë duan ato të sjellen me vetë ato, veçanërisht me ato të cilët dallohen prej tyre, që i përkasin një kulture tjetër ose jan të kufizuar në aftësite e tyre fizike dhe mendore.

**Kujtesë: Dallimet duhet të respektohen dhe secili ka të drejtë të jetë i ndryshem !**

Doracakun origjinal mund ta gjeni në:

<http://unesdoc.unesco.org/images/0018/001841/184162E.pdf>



Projekti i përbashkët i Kombeve të  
Bashkuara për Preventivën e dhunës të  
përkrahur nga UNICEF – i, i financuar nga  
qeveria Holandeze



Биро за развој на образованието  
на Република Македонија



Алгоритам центар